

**BASHKIA TIRANË**  
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Arabel Studio” shpk & “Llazo” shpk

Adresa: Nj. Bashkiake Nr. 8, Rr: “Qemal Stafa”, P.25, hyrja 4, Ap.4, Tiranë

Loti i Tretë: “Aktekspertizë e thelluar për objektet e dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, të klasifikuara sipas shkallës së dëmtimit DS 4 dhe DS 5, në Njësinë Administrative Nr.4, Njësinë Administrative Nr.5, Njësinë Administrative Nr. 6”.

Numri i referencës së procedurës/lotit:Nuk ka.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Procedurë me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës (në rrugë shkresore) e zhvilluar në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 26, datë 15.01.2020 “Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara“, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 10, datë 10.01.2020 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Bashkinë Tiranë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për përballimin e shpenzimeve për inspektimin dhe vlerësimin e dëmeve në njësitë e vetëqeverisjes vendore të prekura nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019”, Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” si dhe mbështetur në ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 për “Prokurimin publik” (i ndryshuar), Kreu III, neni 33, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik”,(i ndryshuar), neni 36, pika 2. Kohëzgjatja e kontratës është 56 (pesëdhjetë e gjashtë) ditë kalendarike duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

Fondi limit: 6,325,560 (gjashtë milion e treqind e njëzetë e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, miratuar me VKB Nr. 2, datë 05.02.2020 “Për një shtesë dhe ndryshim në Venimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr. 157, datë 26.12.2019, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”.

Publikime të mëparshme: Nuk ka.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët.

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. Operatori Ekonomik “Instituti Dekliada-Alb” Shpk, NUIS K71606006A**

Çmimi total i ofertës pa TVSH: 6,300,000 (gjashtë milion e treqind mijë) lekë.

Çmimi total i ofertës me TVSH: 7,560,000 (shtatë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.

**2. Operatori Ekonomik “Net-Group” Shpk, NUIS L72023002P**

Çmimi total i ofertës pa TVSH: 6,245,000 (gjashtë milion e dyqind e dyzetë e pesë mijë) lekë.

Çmimi total i ofertës me TVSH: 7,494,000 (shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë.

**3. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Arabel Studio” shpk & “Llazo” shpk  
NUIS L51802001S & NUIS K24218401K**

Çmimi total i ofertës pa TVSH: 6,240,000 (gjashtë milion e dyqind e dyzetë mijë) lekë.

Çmimi total i ofertës me TVSH: 7,488,000 (shtatë milion e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë.

Nuk ka asnjë operator ekonomik të s’kualifikuar:

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Arabel Studio” shpk & “Llazo” shpk me adresë kryesore Adresa: Nj. Bashkiake Nr. 8, Rr: “Qemal Stafa”, P.25, hyrja 4, Ap.4, Tiranë, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme Çmimi total i ofertës pa TVSH: 6,240,000 (gjashtë milion e dyqind e dyzetë mijë) lekë.

Çmimi total i ofertës me TVSH: 7,488,000 (shtatë milion e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë, me afat të realizimit 56 (pesëdhjetë e gjashtë) ditë kalendarike duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës, është ofertë fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, menjehere me marrjen e këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet Operatori ekonomik “Instituti Dekliada-Alb” shpk, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 7,560,000 (shtatë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 28.07.2020